

VENDIM
Nr. 83, datë 30.3.2021

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “REI – ENERGJI” SHPK, NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “LINGJACA 1”, ME
KAPACITET TË INSTALUAR 1897 *kW*, HEC “LINGJACA 2”, ME KAPACITET TË
INSTALUAR 300 *kW*, ME KAPACITET TOTAL TË INSTALUAR 2197 *kW*
(Ndryshuar me vendimin nr. 228, datë 30.9.2025)**

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “a”, nenit 5, pika 1, germa “a”, nenit 13, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar, si dhe nenit 15, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 30.3.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 39/2 prot., datë 24.3.2021, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi licencimin e shoqërisë “Rei – Energi” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Lingjanca 1”, me kapacitet të instaluar 1897 *kW* dhe “Lingjanca 2”, me kapacitet të instaluar 300 *kW*, me kapacitet total të instaluar 2197 *kW*,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 56, datë 22.2.2021, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “REI – ENERGJI” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Lingjanca 1”, me kapacitet të instaluar 1897 *kW*, HEC “Lingjanca 2”, me kapacitet të instaluar 300 *kW*, me kapacitet total të instaluar 2197 *kW*, me vendndodhje në pellgun ujëmbledhës të lumit të Lingjancës, Bashkia Librazhd, qarku Elbasan, për një afat 25 vjet e 10 muaj.

- Në vijim të vendimmarrjes së ERE-s, me shkresën nr. 6/8 prot., datë 22.2.2021, është bërë publikimi në medien e shkruar në lidhje me fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike për HEC-et: “Lingjanca 1” dhe HEC “Lingjanca 2” dhe në përfundim të afatit të njoftimit, nuk rezulton të ketë pasur vërejtje apo ankesa nga palë të interesuara.

- ERE, me shkresën nr. 424 prot., datë 5.3.2021, ka njoftuar shoqërinë “Rei – Energi” sh.p.k., lidhur me vendimmarrjen e Bordit, për fillimin e procedurave për licencimin e saj në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, duke i bërë me dije nevojën për të depozituar dokumentacionin e konstatuar si të munguar apo plotësuar pjesërisht sipas vendimit nr. 56/2021.

- Shoqëria “Rei – Energi” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 424/1 prot., datë 16.3.2021, ka përcjellë dokumentacionin e munguar.

- Nga analiza e dokumentacionit në fazën përfundimtare të licencimit në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, për shoqërinë “Rei – Energi” sh.p.k., rezulton se subjekti plotëson tërësisht kërkesat e rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Format i dhe dokumentacioni për aplikim, neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b” dhe “c”, plotësuar.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”. Plotësuar;
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”. Plotësuar;
- Dokumentacioni teknik për HEC-in, neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, dhe pika 4.1.4, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”. Plotësuar.

- Leje nga institucione të tjera, neni 9, pika 4.1.5, geramat “a”, “b”, “c”. Plotësuar.
- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t’u pajisur me licencë prodhimi nga ERE, në zbatim të aneksit A, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”.
- Shoqëria ka saktësuar edhe emërtesën e HEC-eve duke konfirmuar se emërtesa e saktë është: “Lingjanca 1 dhe Lingjanca 2” dhe përdorimi në disa nene të kontratave me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) si Lingjaca është gabim ortografik.
- Në përfundim të afatit të kontratës së qirasë me Bashkinë e Përrenjasit (data e përfundimit: 13.05.2027), shoqëria duhet ta depozitojë atë me afate të rinovuara, jo më vonë se një muaj pas nënshkrimit të rinovimit.
- Kontrata nr. 57 REP., nr. 16 KOL., datë 23.1.2012, “Kontratë e formës BOT ndërtim-operim-transferim, për ndërtimin e hidrocentralit “Lingjanca””; ka një afat 35-vjeçar, por, nga ana tjetër, shpjegojmë se ERE, në zbatim të nenit 38, të ligjit “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe nenit 5, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, nuk mund të japë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike një licencë me afat më të madh se 30 vjet.
- Në rastin konkret konstatohet se kontrata e koncesionit sipërcituar është nënshkruar në datën 23.1.2012 (data efektive) dhe si e tillë shoqëria ka humbur 9 vite nga periudha e koncesionit.
- Në nenin 5, “Kohëzgjatja e vlefshmërisë së licencës”, pika 2, të rregullores së licencimit përcaktohet se: për aplikimet në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, të cilat paraqiten në ERE më vonë se data efektive e kontratës/autorizimit, llogaritja e afatit së licencimit, bëhet për periudhën e mbetur. Ky rregull vlen edhe për rastet e modifikimit të licencave”.
- Sa më sipër, nisur nga llogaritja e afateve të humbura të koncesionit, kjo shoqëri duhet të licencohet për një periudhë 25 vjet e 10 muaj.
- Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Rei – Energji” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Lingjanca 1”, me kapacitet të instaluar 1897 *kW*, HEC “Lingjanca 2” me kapacitet të instaluar 300 *kW*, me kapacitet total të instaluar 2197 *kW*, për një afat 25 vjet e 10 muaj.
 2. *Shfuqizuar.*
 3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
- Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.
- Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti